



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 1080/prot.

Elbasan, më 17.05.2021

VENDIM

Nr. 1 datë 17. 05.2021

**"PËR SHPALLJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATURËS
PËR ANËTAR PËRFAQËSUES TË STUDENTËVE NË KOMISIONET
ZGJEDHORE TË FAKULTETEVE TË UNIVERSITETIT TË ELBASANIT
"ALEKSANDËR XHUVANI" "**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", neni 6, KIZ më datë 17.05.2021,

VENDOSI:

1. Të shpallë procesin e kandidimit për anëtar përfaqësues të studentëve në Komisionet zgjedhore të fakulteteve të UE-së si më poshtë:
 - Fakulteti Ekonomik
 - Fakulteti Shkencave Mjekësore Teknike
 - Fakulteti Shkencave të Natyrës
2. Regjistrimi i kandidatëve fillon më datë 17.05.2021 dhe përfundon më datë 18.05.2021, ora 12:00.
3. Kandidatët studentë të interesuar të dorëzojnë pranë sekretarit të KIZ kërkesën për vetëkandidim.
4. Ky vendim të publikohet në faqen elektronike zyrtare të UE-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI

Kryetar: Arjan Hyka

Anëtar: Artan Lila

Anëtar: Marsida Duci (Pasholli)

Anëtar: Mitilda Gugu

Anëtar: LuanKola

Anëtar: Marsel Sulanjaku

Anëtar: Klejd Tollumi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 1089 prot.

Elbasan, më 17 05.2021

V E N D I M

Nr. 2datë 17.05.2021

Për fillimin e procesit zgjedhor dhe datën e zhvillimit të zgjedhjeve jashtë radhe për disa autoritete e organe drejtuese si dhe komisione të përhershme të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"

Në zbatim të nenit 4, 5, 6 e në vijim të Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" miratuar me Vendim Nr.10, datë 12.02.2020 të Senatit Akademik të UE dhe në Urdhrin nr....datë 15.05.2021 të Rektorit të Universitetit të Elbasanit "A. Xhuvani" "Për shpalljen e zgjedhjeve të pjesshme në njësitë kryesore të UE, KIZ në mbledhjen e datës 17.05.2021

V E N D O S I :

1. Të shpallë fillimin e procesit zgjedhor për zgjedhjen e autoriteteve dhe organeve drejtuese në njësitë kryesore si më poshtë:

- Autoritete drejtuese

- a. Në Fakultetin e Shkencave Humane për postin e autoritetit drejtues Përgjegjës i Departamentit të "Letërsisë dhe gazetarisë"
- b. Në Fakultetin e Shkencave Humane për postin e autoritetit drejtues Përgjegjës i Qendrës së Studimeve Albanologjike dhe Ballkanologjike"
- c. Në Fakultetin e Shkencave Humane për postin e autoritetit drejtues Përgjegjës i Departamentit të "Histori- gjeografisë".
- d. Në Fakultetin Ekonomik për postin e autoritetit drejtues Përgjegjës i Departamentit të "Financë-kontabilitetit"
- e. Në Fakultetin Ekonomik për postin e autoritetit drejtues Përgjegjës i Qendrës për Kërkime dhe Zhvillime në Drejtësi dhe Ekonomi".

- f. Në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike për postin e autoritetit drejtues Përgjegjës i Departamentit të “Lëndëve klinike”.
- g. Në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike për postin e autoritetit drejtues Përgjegjës i Departamentit të “Infermieristikës”.
- h. Në Fakultetin e Shkencave të Edukimit për postin e autoritetit drejtues Përgjegjës i Qendrës për Kërkim dhe Zhvillim në Edukim”

- Organe drejtuese

- a. Anëtar i Senatit Akademik përfaqësues i studentëve.

- Komisionet e përhershme të Njësive kryesore

- a. Komisioni për garantimin e Standardeve të cilësisë së Njesisë Kryesore dhe programeve të studimit në të gjitha Njësitë kryesore
 - b. Komisioni për mbrojtjen e studentëve në të gjithë Njësitë kryesore
2. Të miratojë periudhën e zhvillimit të procesit zgjedhor nga data 17.05.2021 deri në datën 17.06.2021
3. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritete dhe organe drejtuese, si dhe komisione të përhershme më Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” të jetë data 17.06.2021

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI

Kryetar: Arjan Hyka

Anëtar: Artan Lila

Anëtar: Marsida Duci

Anëtar: Mitilda Gugu

Anëtar: Luan Kola

Anëtar: Marsel Sulanjaku

Anëtar: Klejt Tollumi